



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT “ GJERGJI JANO “

Nr. 209 Prot

Korce më 06.07.2020

Nr. 353 Dosje

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar : QENDRES KOMBETARE BIZNESIT (QKB - TIRANE)

Unë, Gjergji Jano , me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat në zbatim të Titullit të Ekzekutimit Nr.256 Akti datë 24.02.2020 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce , kam vënë në ekzekutim këtë Titull, duke regjistruar në dosjen përbarimore Nr.353 Datë 06.07.2020 kërkesën e kreditorit “ *Albert Latka* ” ndaj debitorit Shoqërisë tregëtare “*New Style Italian*” Shpk në lidhje me titullin ekzekutiv vendimi Nr.256 Akti datë 24.02.2020 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce

Pasi fillova menjehere procesin e ekzekutimit të detyrueshëm per detyrimin që përmban Titulli i Ekzekutimit vendimi Nr.256 , datë 24.02.2020 në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile

KONSTATOVA Se :

Nga informacioni i dhene me shkrim nga pala kreditore i cili pretendon se nga ana e debitorit gjate kohes se lajmerimit vullnetar mund te kryhen veprime per tjetersimin e pronesise se sendeve te luajtshme dhe te paluajtshme te cilat jane ne emer te tij gjykoj se mosveprimi ne kohe do te bente te pamundur ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm , duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit Shoqëria “*New Style Italian*” Shpk në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (e), 37 pikat (b;c) dhe neni 53 të Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1) Vendosjen e mases se sekustros konservative mbi te gjitha aksionet e zoteruara nga debitori :

- Shoqeria tregëtare "New Style Italian" shpk me Nr Nipt-i L81813006U, me administrator z.Roberto Casini

2) Per veprimet apo mosveprimet tuaja na vini ne djeni shkreserisht brenda afatit ligjor.

3) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedures Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

4) Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

Përmbartuesi GJYQËSOR
Gjergji JANO

